




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**MINISTRIA E EKONOMISË ,KULTURES DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK Fier**

Nr 251 Prot

Fier më, 25 .07.2025

Lënda: Njoftim për Levizje Paralele .

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

DREJTORISË SË MARRËDHENIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, “Për nxitjen e punësimit” ; të ligjit nr 15/2017 “ Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 “ Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombetare të punësimit dhe aftësive “ ; të udhëzimit Nr 759 datë 30.09.2024 “ Për mënyrën e organizmit dhe veprimtarisë menaxhimit te burimeve ,përberës së njesisë së zhvillimit të institucioneve ,ofruesve te arsimit dhe formimit professional dhe zhvillimit të vazhdueshem profesional të personelit ”.

Ofruesi i AFP_së, Qendra e Formimit Profesional Publik Fier , ju njofton Levizje Paralele për pozicionin:

Pergjegjes I Sektorit te Administrimit te Formimit Profesional Publik Fier :

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme :

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a)Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b)Të jetë në kushte shëndetësorë që e lejojnë të kryejë detyrën
- c)Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d)Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e)Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- f)Të demostroj aftësi te punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a)Të ketë diplome te studimeve universitare te nivelit “Master shkencor ” (ose te barazvlefshme)ne nje nga fushat qe lidhen me kualifikimet profesionale ne lidhje me ofrusit publik te AFP-se .

- b) Të ketë të paktën 3 (vjet) përvojë pune në një ofrues publik të AFP-së .
c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit .

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikantit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë , duhet të përfshijë.

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në)
- c) kartën e indentitetit
- d) diplomë/deftese e shkollës së mesme
- e) librezë e punës

f) çdo dukumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim CV;

- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim i gjëndjes shëndetësore
- i) vërtetimin e gjëndjes gjyqësore
- j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka masë disiplinore në fuqi
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre ;
Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës. 06.08.2025

DREJTORI

Aleksander Lalaj

